



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

K.Dh.Shk.II.nr.830/2024

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS – Dhoma e Shkallës së Dytë, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Franciska Zhitija - Ymeri, kryetare e kolegjit, Saranda Bogaj Sheremeti dhe Faton Bajrami, anëtare të kolegjit, në çështjen juridike kontestimore të propozuesit të masës së sigurisë-paditësit “PREMIUM KS” Sh.p.k me NUI; 810833592, me seli në Prishtinë, të cilën sipas autorizimit e përfaqëson Arbër Shala avokat në Prishtinë, kundër kundërshtarit të sigurimit-paditurit Ministria Për Komunitete dhe Kthim me seli në Fushë Kosovë, të cilën me autorizim e përfaqëson Avokatja Shtetërore Naime Abazi, për shkak të caktimit të masës së sigurisë, duke vendosur lidhur me ankesën e kundërshtarit të sigurimit-paditurit, të parashtruar kundër Aktvendimit të Gjykatës Komerciale të Kosovës – Dhomat e Shkallës së Parë, KE.nr.917/2023, i datës 29.12.2023, në seancën e kolegjit të mbajtur me dt.16.04.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

APROVOHET ankesa e kundërshtarit të sigurimit Ministria Për Komunitete dhe Kthim me seli në Fushë Kosovë dhe **ANULOHET** aktvendimi i Gjykatës Komerciale të Kosovës, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, KE.nr.917/2023, i datës 29.12.2023, dhe lënda i kthehet në Gjykatës Komerciale të Kosovës-Dhoma e Shkallës së Parë-Departamenti për çështje ekonomike në rishqyrtim dhe rivendosje.

A r s y e t i m

Gjykata e shkallës së parë, në aktvendimin e ankimuar, ka vendosur si në vijim:

“I.APROVOHET si e bazuar propozimi propozuesit të masës së sigurimit/paditësit “PREMIUM KS” Sh.p.k, i paraqitur kundër të paditurit/kundërshtarit të masës së sigurimit Ministria Për Komunitete dhe Kthim , CAKTOHET masa e sigurisë dhe i NDALOHET kundërshtarit të masës së sigurimit/paditurës Ministria Për Komunitete dhe Kthim, konfeskimi i sigurimit të ekzekutimit të tenderit “ Ndërtimi dhe renovimi i shtëpive për të kthyerit dhe komuniteteve në nevojë” me numër të prokurimit 211-20-5436-5-1-1, sipas Vendimit me numër 5198, të datës 15.11.2023 dhe Vendimit me numër 5208, të datës 22.11.2023.

II. Masa e sigurimit mbetet në fuqi deri sa mos të jepet vendim tjetër mbi masën e sigurimit.”

Kundër këtij aktvendimi në afatin ligjor ankesë ka paraqit kundërshtari i masës së sigurimit, për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, si dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale duke i propozuar gjykatës së shkallës së dytë që të aprovojë ankesën si të bazuar ta prish aktvendimin KE.nr.917/2023, i datës 29.12.2023, si dhe të refuzohet në tërësi si e pa bazuar propozimi i propozuesit të masës së sigurisë.

Përgjigje në ankesë ka paraqitë propozuesi i masës së sigurisë me të cilën ka propozuar që të refuzohet ankesa e paditurit si e pa bazuar dhe të vërtetohet aktvendimi i ankimuar.

Kolegji i Dhomës së Shkallës së Dytë i Gjykatës Komerciale të Kosovës, pas shqyrtimit të shkresave të lëndës secilin veç e veç dhe analizës së tyre si dhe pas shqyrtimit të aktvendimit e ankimuar, pretendimet ankimore të propozuesit të masës së sigurisë, e po ashtu edhe përgjigjet e kundërpropozuesve ndaj ankesës dhe vlerësimit të tyre në kuptim të nenit 194 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, ka gjetur se:

Ankesa është e themeltë.

Nga shkresat e lëndës rrjedh se paditësi - propozuesi i masës së sigurisë “PREMIUM KS” Sh.p.k, me seli në Prishtinë, me datën 21.11.2023 pranë gjykatës së shkallës së parë kanë paraqitur padi, njëherit ka paraqit edhe propozim për caktimin e masës së sigurisë ndaj kundërshtarit të sigurimit Ministria Për Komunitete dhe Kthim, me seli në Fushë Kosovë, ndërsa me datën 06.12.2023 ka dorëzuar parashtrësën me sqarime plotësuese në lidhje me propozimin për caktimin e masës së sigurisë, me të cilën ka kërkuar që të aprovohet propozimi për caktimin e masës së sigurisë dhe të caktohet masa e sigurisë dhe t’i

ndalohet kundërshtarit të sigurimit që të realizoj konfiskimin e sigurimit të avansit sipas Vendimit nr.5198 të datës 15.11.2023 në shumë prej 281,311.90euro dhe të realizoj konfiskimin e sigurimit të ekzekutimit sipas Vendimit nr.5208 të datës 22.11.2023, në shumën prej 219.900.00euro dhe në shumën prej 158.750.00euro, dhe nëse kundërshtari i sigurimit nuk e rreskton masën e sigurisë t'ia kompenzoj propozuesit të sigurimit dëmin e shkaktuar në pajtim me dispozitat e nenit 154 të LMD-së, si dhe për këtë aktvendim të njoftohet KS "Elsig" me seli në Prishtinë.

Gjykata e shkallës së parë duke vendosur sipas propozimit për caktimin e masës së sigurimit, me aktvendim, e ka aprovuar propozimin e propozuesit për caktimin e masës së sigurisë si në dispozitiv të aktvendimit të ankimuar, me arsyetim se janë plotësuar kushtet ligjore të parapara me nenin 297 par.1 pikat a) dhe b) të LPK-së. Ndër të tjera ka theksuar se bazuar në provat të cilat gjinden në shkresa të lëndës gjatë shikimit të sigurimit të Ekzekutimit të tenderit- me numër 0056286 të datës 22.10.2020, në shumën totale prej 158,750.00euro, numër 0056285 të datës 20.10.2020 në shumën totale prej 219,900.00 euro, të lëshuar në emër të sigurimit të ekzekutimit të tenderit "Ndërtimi dhe renovimi i shtëpive për të kthyerit dhe komuniteteve në nevojë" me numër prokurimi 211-20-5436-5-1-1, gjeti se garancionet në fjalë me kërkesë të parë, do ti lëshohen autoritetit kontraktues-Ministria për Komunitete dhe Kthim, nga Kompania e Sigurimeve Elsig, në emër të Operatorit Ekonomik "PREMIUM KS" Sh.p.k në rast se; a) *Autoriteti kontraktues konstaton në bazë të dëshmive të vërtetuara objektivisht se operatori ekonomik ka dështuar që të ekzekutoj kontratën e nënshkruar dhe kjo i ka shkaktuar autoritetit kontraktues dëme substanciale dhe/ose shpenzime të mëdha për mbylljen e kontratës në fjalë, dhe b) *Operatori Ekonomik ka dështuar që të ekzekutoj kontratën e nënshkruar dhe si rezultat i saj kanë mbetur pa u paguar shumë puntorë, nënkontraktorë dhe/ose furnizues të materialeve. Kështu gjykata e shkallës së parë ka shtuar se pavarësisht faktit se në rastin konkret është përcaktuar se garancioni do të ekzekutohet me kërkesën e parë të autoritetit kontraktues, i njëjti përbën garancion me kusht, për ekzekutimin e të cilit kërkohet që të vërtetohet në mënyrë objektive, dështimi i operatorit ekonomik në ekzekutimin e kontratës dhe shkaktimi i dëmeve autoritetit kontraktues si pasojë e mos ekzekutimit të të njëjtës, e që në rastin konkret propozimi për caktimin e masës së sigurisë për ndalimin e ekzekutimit të sigurimit të ekzekutimit të tenderit është e bazuar, për faktin se me asnjë provë kundërshtari i masës së sigurimit, nuk ka arritur që ta vërtetoj faktin se është plotësuar kushti i përcaktuar në këtë garancion dhe se të njëjtit në këtë fazë të procedurës i takon e drejta për ekzekutimin e garancionit, që i njëjti në cilësinë e përfituesit e ka të drejtën t'i drejtohet siguresit/garantuesit për marrjen e dëmshpërblimit deri në shumën e garantuar, meqenëse në këtë fazë të procedurës, kundërshtari i sigurimit nuk ka arritur që**

të provoj faktin se detyrim kontraktuale nuk janë përmbushur si pasojë e mos veprimit të propozuesit të masës së sigurisë. Po ashtu ka cek se bazuar në dispozitat e nenit 297.1 nënpikën a) dhe b) të LPK-së, propozuesi i masës së sigurisë ka arritur ta bëjë të besushëm ekzistimin e të drejtës së tij subjektive e po ashtu edhe ekzistimin e rrezikut se mos caktimi i masës së sigurimit do të ndikonte negativisht në të drejtat e propozuesit të sigurimit si dhe propozuesit të masës së sigurisë do t'i shkaktohej dëm i konsiderueshëm i cili vështirë do të mund të riparohej.

Nisur nga një gjendje e tillë faktike e çështjes, Dhoma e Shkallës së Dytë vlerëson se përfundimi dhe qëndrimi juridik i gjykatës së shkallës së parë është i gabuar pavarësisht se aktvendimi i ankimuar nuk është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika b), g), j), k) dhe m) e LPK-së, për të cilat Dhoma e Shkallës së Dytë kujdeset sipas detyrës zyrtare, por gjendja faktike dhe e drejta materiale është zbatuar në mënyrë të gabuar, prandaj Dhoma e Shkallës së Dytë ka vendosur që ta anuloj aktvendimin e ankimuar dhe çështje ta kthej në rivendosje.

Dhoma e Shkallës së Dytë duke shqyrtuar ankesat e kundërpropozesit të masës së sigurisë brenda kufijve, gjeti se propozuesi "PREMIUM KS" Sh.p.k ka paraqitë propozim për caktimin e masës së sigurisë në Gjykatën Komerciale të Kosovës-Dhoma e Shkallës së Parë-Departamenti Për Çështje Ekonomike. Propozimin e ka paraqit s'bashku me kërkesëpadi me të cilën ka kërkuar që në emër të mosëpërmbushjës së kontratës dhe fitimit të humbur ti paguaj paditësit shumën prej 2,800.00euro.

Pas vlerësimit dhe shqyrtimit të shkresave të lëndës së cilën veq e veq e edhe lidhshmërin e tyre Gjykata e Dhomës së Shkallës së Dytë ka vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi, për shkak se për caktimin e masës së sigurisë sipas dispozitës së nenit 297.1 nënpikën a) dhe b) të LPK-së kërkohen që të plotësohen dy kushte në mënyrë kumulative që do të thotë se njëra prej tyre nuk plotësohet atëherë masa e sigurisë nuk mund të caktohet. Në këtë çështje kontestuese në mesë palëve është fakti se me ekzekutimin e garancioneve, më hollësisht të përshkruara në dispozitivin e parë (I) të aktvendimit të ankimuar a do të mund të pamundësohet apo vështërsohet dukshëm realizimi i kërkesëpadisë.

Gjykata e shkallës së parë nuk ka dhënë arsyetim lidhur me këtë fakt kontestues, se pse vështërsohet apo pamundësohet dukshëm realizimi i kërkesëpadisë nëse kjo masë e sigurisë nuk shqiptohet kur është e ditur se kundërshtari i propozimit është institucion shtetëror dhe ka buxhet të konsoliduar dhe të përhershëm. Po ashtu nuk ka dhënë arsye se propozuesi i masës së sigurisë me cilat prova ka arritur të bëjë të besushëm kërkesën e saj e sidomos faktin se pa masën e sigurimit vështërsohet në mënyrë të dukshme apo pamundësohet realizimi i kërkesëpadisë. Sepse kolegji i kësaj gjykate konsideron dhe

thekson se po që se propozuesi e realizon kërkesëpadin e vet atëherë e realizon edhe shumat sipas sigurimit të garancionit të tenderit, të deponuar si garancion në rast të mospërbushjes së kontratës edhe atë me kamatë ligjore nga dita e deponimit të padisë pranë gjykatës. Po ashtu gjykata e shkallës së parë duhet ta shqyrtoj edhe legjitimitetin e palës së paditur-kundërshtarit të propozimit të masës së sigurisë, ngase në rastin konkret padia e paditësit-propozuesit të masës së sigurisë rezulton të jetë një dikaster qeverisës, e ku për Dhomën e Shkallës së Dytë nuk është e qartë fakti se si i till a ka zotësi juridike, ngase kontrata është lidhurë në mesë të Qeverisë së Kosovës-Ministria për Komunitete dhe Kthim dhe “PREMIUM KS” Sh.p.k, ndërsa në padi si dhe në propozim për caktimin e masës si palë e paditurë-kundërshtar i propozimit të masës së sigurisë është vetëm Ministria për Komunitete dhe Kthim.

Pra krejt në fund, Gjykata e dhomës së shkallës së parë edhe njëherë të vlerësoj të cekurat në këtë aktvendim, të vlerësoj të gjitha provat dhe të nxjerrë vendim të drejtë të arsyetuar, një nga një për secilin fakt në mënyrë që të elemenohen shkeljet e cekura më lartë.

Nga sa u tha më lartë e në bazë të nenit 209 par.1 nën d) të LPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS-Dhomat e Shkallës së Dytë

K.Dh.Sh.II.nr.830/2024, me datën 16.04.2024

Kryetare e kolegjit

Franciska Zhitija Ymeri